

VENDIM
Nr.752, datë 9.11.2006

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS TË
SHTËPISË SË OFICERËVE, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të shtëpisë së oficerëve, Gjirokastrë, inventarizuar si pronë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.
 2. Objekti të jetë në përdorim të universitetit “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për një afat deri në 5 vjet.
 3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Mbrojtjes të nxjerrin aktet e nevojshme ligjore, në zbatim të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha